

Syllabusi i lëndës HADITHI –I- semestri II

Lënda: Hadith I - *Terminologjia e Hadithit*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 108

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2026/2027

Semestri: II

Mësimdhënësi: Prof. asoc. Dr. Sulejman Osmani

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Trajtimi i pozitës së Sunetit (si burimi i dytë) në jurisprudencën Islame.
Zhvillimi i shkencës së hadithit përgjatë shekujve.
Hadithologët më të njohur dhe veprimtaria e tyre shkencore, autorët dhe librat.
Qëndrimi i fraksioneve fetare ndaj Sunetit, analizë e parimeve të tyre.
Terminologjia e shkencës së hadithit, parimet bazë dhe ndarja e lëndës mësimore.

Qëllimi i lëndës

Materia e lëndës ka për qëllim studimin e Sunetit si bazë e dytë e Islamit, duke sjellë argumentet fetare nga Kurani dhe Suneti në lidhje me këtë çështje. Studimi synon të hulumtoj ligjshmërinë e trashëgimisë së Pejgamberit a.s. në legjislaturën Islame, ndikimin e tij në jetën praktike dhe faktin se ai paraqet dispozitën ligjvënëse e shpesh herë edhe plotësuese. Gjithsesi është në rolin e sqaruesit dhe komentuesit të dispozitave bazë të nxjerra nga Kurani. Në vazhden e studimit lënda hulumton edhe qëndrimin e fraksioneve fetare ndaj Sunetit, duke analizuar objektivat e tyre në këtë fushë dhe ofrimin e një pasqyre historike të idesë dhe zhvillimit të tyre. Për më tepër, studimi sjell edhe mendimet e atyre që mohuan pozitën e Sunetit në Islam, duke vënë në pah edhe dilemat e tyre, mbështetur në argumentet e supozuara. Të gjitha këto tematika afrojnë mundësi debati dhe hapin idenë e mendimit tjetër, mendimin ndryshme, duke qitur në pah argumentet e secilës palë. Studimi i lëndës synon të sjell një ide të qartë drejt kuptimit të mirëfilltë të pozitës së Sunetit në Islam.

Studimi i lëndës sjell para studentëve autorët më të mëdhenj të shkencës së hadithit, të cilët paraqesin kapacitetet kryesore të kësaj lëmie, zbulon mundin dhe kontributin e tyre veçanërisht në fushën e hadithit. Duke sjellë modelin e tyre dhe produktin shkencor studenti stimulohet për angazhime edhe më serioze. Lënda synon të ofroj njohuri të qarta rreth zhvillimit të shkencës së hadithit në periudha të ndryshme kohore dhe ecje e saj nëpër shekuj.

Rezultatet e pritura të nxënies:

1. Të kuptoj drejt rolin e Sunetit në Islam
2. Të njoh argumentet fetare që krijojnë bazë ligjore për pozitën e Sunetit në Islam.
3. Të komunikoj me tjerët dhe të ketë qasje reale ndaj tematikave të trajtuara.
4. Të shprehet me përgjegjësi rreth pozicionimit të fraksioneve fetare përball Sunetit.
5. Të promovoj ide që shkojnë në favor të temës.
6. Të krijoj ide të qartë rreth mënyrës së transmetimit të asaj që është trashëguar nga Pejgamberi a.s.
7. Do të njoftohet me kategori të ndryshme të haditheve dhe do të jetë në gjendje ti identifikoj ato.
8. Kupton shkallën e lartë të kritikës shkencore të cilën e kanë aplikuar studiuesit islam me qëllim të ruajtjes me saktësi së asaj që është transmetuar nga Pejgamberi a.s.

Metodologjia e mësimdhënies:

1. Mësimi zhvillohet në formë të ligjëratave, që kryesisht janë të natyrës teorike.
2. Stimulimi i studentëve në diskutime interaktive, duke ballafaquar idetë dhe argumentet.
3. Nxitja për hulumtimin e literaturës shtesë e cila promovon idetë e reja dhe identifikon gjithpërfshirjen e njohurive të lëndës.
4. Ofrimi i tematikave për hulumtime në fushat që kanë të bëjnë në lidhje me lëndën.
5. Puna kërkimore në bibliotekë ku studenti mëson metodat e kërkimit të haditheve dhe hulumtimin pas tyre.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë:

1. Njohja me përmbajtjen e lëndës, 2. Temat kryesore dhe synimet e saj 3. Analizë e syllabusit
4. Suneti si bazë e shariatit Islam. 5. Roli i Sunetit në formimin e personalitetit Islam
6. Domethënia e Sunetit dhe termat tjera. 7. Defenicioni i Sunetit.8. Fjalët, veprat dhe pëlqimet e Muhamedit a.s. 9. Veçoritë personale dhe morale të Muhamedit a.s.
10. Shkenca mbi terminologjinë e Hadithit, hyrje dhe zhvillimet në kohë

Literatura: Libri: "Pozita e Sunetit në Islam" autor Sulejman Osmani (faqe 5-25)

- Bazat e Hadithit, autor Musa Vila, f.13-29

Java e dytë:

1. Termi El Hadithu. 2. El Haberu 3. El Etheru" 4. Argumentet fetare që na obligojnë të veprojmë sipas Sunetit. 5. Kurani 6. Mbrojtja dhe ruajtja e Pejgamberit a.s.7. Suneti-argument për Sunetin. 8. Pamundësia e të vepruarit vetëm me Kuran.

Literatura: Pozita e Sunetit në Islam" autor Sulejman Osmani (faqe 26-49)

Java e tretë:

1. A mund të pavarësohet Suneti në nxjerrjen e dispozitave. 2. Fakti se Suneti është i dy kategorive- argument për sunetin. 3. El Ixhmau-argument për Sunetin 4. Metodika e Muhamedit a.s. gjatë edukimit. 5. Kontributi i sahabëve në ruajtjen e hadithit 6. Gjendja e hadithit gjatë jetës së Pejgamberit a.s. 7. Gjendja e Sunetit pas vdekjes së pejgamberit a.s. 8. Urdhëri i Umer bin Abdulazizit për tubimin e hadithit" 9. Mënyrat e pranimit të hadithit,

Literatura: i njëjti libër (faqe 50-80)

-Hyrje në shkencën e hadithit, Fahrudin Ebibi, (f.45-57)

Java e katërt:

1. Brezi i sahabëve të Pejgamberit a.s. 2. Me çka vërtetojmë se dikush është sahabi. 3. Sahabët në peshojën Islame. 4. Sa është numri i sahabëve. 5. Disa njohuri rreth sahabëve ..." 6. Gjendja e hadithit gjatë shekullit të dytë. 7. Nga trashëgimia e shekullit të dytë. 8. Imam Maliku dhe Muvetai i tij.

Literatura: Pozita e Sunetit në Islam" autor Sulejman Osmani (faqe 81-116)

Java e pestë:

1. Hadithi gjatë shekullit të tretë 2. Imam Ahmedit dhe Musnedi i tij. 3. Musnedi i imam Ahmedit. 4. Cilës kategori i perkasin hadithet e Musnedit. 5. Nga shekulli i artë-metoda e tretë e mbledhjes së haditheve. 6. Imam Buhariu dhe Sahihu i tij 7. Çka thanë dijetarët për të. 8. Sahihu i Buhariut. 9. Imam Muslimi dhe Sahihu i tij. 10. Krahasimet midis dy Sahihëve. 11. Kushti i tyre në hadithet e regjistruara.

Literatura: i njëjti libër (117-155)

Java e gjashtë:

1. A kanë arritur të bëjnë mbledhjen e të gjitha haditheve të vërteta? 2. Hadithet e dy Sahihëve në mes bindjes së prerë dhe dyshimit të mundshme. 3. Mendimi i imam Neveviut. 4. Mendimi i shumicës (xhumhurit).

1. Përmbledhjet e katër Sunenëve 2. Ebu Davudi dhe Suneni i tij 3. Kushtet e Ebu Davudit 4. Hadithet më të dalluara 5. Imam Nesaiu dhe Suneni i tij.

Literatura: i njëjti libër (faqe 155-170)

Java e shtatë: Seminar – kollokfishum**Java e tetë:**

1. Imam Tirmidhiu dhe Suneni i tij 2. Xhamiu (Suneni) i Tirmidhiut 3. Krahasime në mes tre Sunenëve 4. Ibën Maxhe dhe Suneni i tij 5. Suneni i Ibën Maxhes 6. Gjendja e hadithit pas shekullit të tretë, 7. Sahihu i Ibën Huzejmes, 8. Sahihu i Ibën Hibanit 9. Mustedreku i Hakimit.

Literatura: Pozita e Sunetit në Islam (faqe 171-184)

Java e nëntë:

1. Hadithi pas shekullit të katërt. 2. Librat më të njohur të kësaj periudhe. 3. Tubimi i haditheve nga librat e ndryshëm në një përmbledhje. 4. Tubimi i haditheve nga librat e ndryshëm. 5. Gjendja e hadithit pas shekullit të gjashtë 6. Disa nga hadithologët më të njohur; Iraku, Ibën Haxheri. 7. Metoda e re në tubimin e haditheve (kutubu Ez Zevaid). 8. Enciklopedit e haditheve (EL Xhevami)

Literatura: i njëjti libër (faqe 184 - 206)

Java e dhjetë:

1. Shkollat e Hadithit në kohë. 2. Kontributi i dijetarëve shqiptar dhënë shkencës së hadithit. 3.

Nasirudin Albani. 4. Abdulkadër Arnauti. 5. Shuajb Arnauti

1. Fraksionet fetare dhe qëndrimi i tyre ndaj hadithit. 2. Shiitët dhe qëndrimi i tyre ndaj hadithit. 3. Zanafilla e mendimit shiit. 4. Shiitët në ndarjen e tyre të brendshme.

1. Havarixhët dhe qëndrimi i tyre ndaj Sunetit. 2. Devijimet e havarixhëve si rezultat i mospërfilljes së sunetit. 3. Suneti dhe Mutezilët. 4. Qëndrimi i tyre ndaj disa kategori hadithesh.

Literatura: I njëjti libër (faqe 206 - 237)

Java e njëmbëdhjetë: Seminare - Kollokfijum

Java e dymbëdhjetë:

1. Orientalistët dhe qëndrimi i tyre ndaj Hadithit. 2. Disa nga orientalistët më të njohur. 3. Gold Ziher dhe pikëpamjet e tij. 4. Akuzat ndaj imam Zuhriut. 5. Nga veprimtaria pozitive e orientalistëve.

6. Suneti dhe Mohuesit e tij 6. Ndarja e tyre në tri grupe. 7. Individë që mohuan Sunetin. 8. Qëndrimi i Umetit ndaj mohuesëve të Sunetit.

Literatura: I njëjti libër (237 - 258)

Java e trembëdhjetë:

1. Dilema rreth argumentimit me Sunet. 2. Dilema e parë (hadithi). 3. Dilema e dytë (ajeti) 4. Dilema e tretë.

5. Arsyet e mosargumentimit me hadithe të caktuara. 6. Thirrjet e dijetarëve për respektimin e hadithit. 7. Arsyet kryesore që kanë bërë të anashkalohe argumentimi me ndonjë hadith.

Literatura: I njëjti libër (faqe 258-276)

Java e katërbëdhjetë:

1. Hadithet ahad dhe argumentimi me to. 2. Mendimet e dijetarëve. 3. Argumentet e dy palëve. 4. Kjo polemikë a ka qenë e njohur te gjeneratat e mëhershme.

5. Hadithet Kudsij 6. Cili është burimi i tyre. 7. Dallimet në mes haditheve Kudsij dhe Kuranit.

8. Hadithet Mevdua (të shpifura) 9. Imam Ebu Hanife dhe rëndësia e tij në shkencën e hadithit

10. Parimet e medh'hebit të tij në nxjerrjen e dispozitave. 11. Çfarë fondi të hadithit ka poseduar Ebu Hanifja. 12. Ai ka dhënë përparësi mendimit të lirë ndaj hadithit.

Literatura: i njëjti libër (faqe 277-311)

Java e pesëmbëdhjetë:

Konsultime, ushtrime dhe përgatitje për provimin përfundimtar

Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: **10 pikë**

Punimi seminarik: **20 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **30 pikë**

Provimi final: **40 pike**

Literatura obliguese:

1. Sulejman Osmani, Pozita e Sunetit në Islam, Prishtinë, 2017

2. Bazat e Hadithit, Mr. Musa Vila, Prishtinë 2009

Literatura konsultative:

1. *Kurani*; përkthim dhe komentim, përktheu: H. Sherif Ahmeti. Medinë, 1992.
2. Ibrahim Dalliu, *Udha Muhamedane*, botoi AIITC, Tiranë, 2000
3. Jusuf el-Kardavi, *Të Kuptuarit e Sunetit-Orientime Metodologjike dhe Rregulla*, Gjilan, 2001.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Ligjëratat janë të karakterit obligativ andaj studentët duhet të vijojnë mësimin në mënyrë të rregullt. Për stimulimin e pjesëmarrjes sa më të rregullt, në kriterin e vlerësimit janë ndarë 10 pikë. Me qëllim të arritjes së cilësisë dhe kualitetit studentët stimulohen për mësim dhe angazhime edhe më të mëdha. Vazhdimisht punohet në formimin e karakterit të fortë i cili reflekton vlerat e tij kudo qoftë. Rregullat e mirësjelljes e bëjnë studentin dinjitoz dhe të dobishëm si në pikëpamjen fetare po ashtu edhe në atë morale. Ndër të tjera studentët porositen të sillen mirë me të tjerët e të përhapin dukurit pozitive, të ndihmojnë njëri tjetrin, të kultivojnë tolerancën brenda objektit dhe jashtë tij.